**KONTRATE SHITJE KUOTASH**

Sot, me date **22 Dhjetor 2021** (dymije e njezet e nje) nenshkruhet kjo kontrate mes paleve:

Z. **Sabri Osma**, shtetas shqiptar, lindur me 13.04.1978 ne Tirane e banues ne Tirane, mbajtes i leternjoftimit me nr. 033389340 dhe nr. personal **H80413059P**, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar;

dhe

(ne vijim referuar si "Shitesit)

Z. **Fabjan Diçi**, shtetas shqiptar, lindur me 27.11.1986 ne Tirane e banues ne Tirane, mbajtes i leternjoftimit me nr. 036085963 dhe nr. personal I61127049B, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar

(ne vijim referuar si "Bleresi")

Ne vijin e per efekt te kesaj Kontrate, Shitesit dhe Bleresi do te referohen vecmas si Pale/a dhe se bashku si

Pale/t. MEQENESE:

**A.** Shoqeria " **GREEN GRAPHICS STUDIO** " Sh.P.K., eshte nje shoqeri tregtare me pergjegjesi te kufizuar e krijuar e qe funksionon ne perputhje me legjislacionin shqiptar, regjistruar ne Qendren Kombetare te Regjistrirnit me Numer Unik Identifikirni **M11320022Q**, me kapital themeltar **100.000 Leke**, te zoteruara ne masen **100%** nga Ortaku **Sabri Osma.**

(me poshte referuar "Shoqeria").

**B.** Shitesi deshiro ti transferojen kuotat te kapitalit te zoteruar prej tij ne Shoqeri dhe Bleresi ka pranuar ti bleje kuotat e zoteruara dhe te ofruar nga Shitesi ne Shoqeri;

**C.** Ne zbatim te kerkesave te Statutit te Shoqerise, Palet kane vendosur te lidhin kete Kontrate;

ATEHERE, duke qene se ekzistojne keto kushte paraprake, per te cilat Palet nuk kane pretendime apo kundershtime. Palet bien dakord per sa me poshte vijon:

**Neni 1** Objekti

1.1 Nepermjet kesaj Kontrate :

-Shitesi **Sabri Osma** i shet Bleresit 1 kuote e barabarte me 100% te kapitalit te zoteruar prej tij

dhe Bleresi blen nga Shitesit 1 kuota te barabarta me 100% te kapitalit te zoteruar nga Shitesi ne kapitalin themeltar te Shoqerise " **GREEN GRAPHICS STUDIO** " Sh.P.K., shoqeri tregtare me pergjegjesi te kufizuar, e regjistruar prane Qendres Kombetare te Regjistrimit me Numer Unik Identifikimi NUIS **M11320022Q.**

**Neni 2** Çmimi

2.1 Cmimi i shitjes se 1 kuote e barabarte 100% (njeqind perqind) te kapitalit te zoteruar nga Shitesi ne shoqeri eshte 100.000 Leke ( nje qind mije leke).

2.2 Cmimi i siperpemendur i shitjes eshte paguar teresisht nga bleresi tek shitesi para nenshkrimit te kontrates, dhe palet konfrrmojne se nuk kane pretendirne ne lidhje me cmimin e shitjes dhe menyren e pageses.

**Neni 3** Deklarimet dhe garanci

3.1 Shitesi deklaron dhe verteton se ne daten e nenshkrimit te kesaj Kontrate ai zoteron kuotat qe do te transferohen sipas kesaj Kontrate, dhe ka te drejten per ti transferuar keto kuota dhe se nenshkrimi apo zbatimi i kesaj Kontrate nga Shitesi nuk vjen ne kundershtim me ligjet, Statutin, kontratat, marreveshjet apo dokumente te tjera ligjore, subjekt i te cilave eshte Shitesi.

3.2. Bleresi deklaron dhe verteton se ne daten e nenshkrimit te kesaj Kontrate Bleresi ka tagra te plota per te pranuar kuotat nga Shitesi sipas percaktimeve te kesaj Kontrate dhe se nenshkrimi apo zbatimi i kesaj Kontrate nga Bleresi nuk vjen ne kundershtim me ligjet, Statutin, kontratat, marreveshjet apo dokumente te tjera ligjore, subjekt i te cilave eshte Bleresi.

**Neni 4** Transferimi i te drejtave mbi kuotat

4.I. Pronesia mbi kuotat e Shoqerise, objekt i kesaj Kontrate, kalon nga Shitesi te Bleresi menjehere me nenshkrimin e kesaj Kontrate dhe qe nga ky moment Bleresit i lind e drejta e regjistrimit te kesaj kontrate ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe Shitesi bie dakort per kete.

4.2. Menjehere me nenshkrimin e kesaj kontrates Bleresi behet ortak i Shoqerise duke zoteruar 1 kuote e barabarte me 100% te kapitalit te shoqerise me vlere 100.000Leke.

4.3. Me nenshkrimin e kesaj Kontrate, Bleresi gezon te gjitha te drejtat per te regjistruar pronesine mbi kuotat e zoteruara ne emer te tij ne Regjistrin Tregtar prane Qendres Kombetare te Regjistrimit si dhe prane çdo institucioni tjeter shteteror sipas legjislacionit ne fuqi dhe per ndjekjen e kesaj procedure autorizon : Z. **Fabjan Dici**, me numer. Personal I61127049B.

**Neni 5** Te ndryshme

5.1. Cdo kusht, klauzole apo parashikim i kesaj Kontrate do te jete i vlefshem pavaresisht kushteve, klauzolave apo parashikimeve te tjera dhe vlefshmeria e nje kushti, klauzole apo parashikimi nuk do te cenohet nga pavlefshmeria e nje kushti, klauzole apo parashikimi tjeter,

5.2. Kjo Kontrate do te interpretohet dhe zbatohet ne perputhje me dispozitat e Ligjit 990112008, te ndryshuar dhe Kodit Civil te Republikes se Shqiperise.

5.3. Cdo konflikt qe ka lindur si pasoje apo lidhet me kete Kontrate do te zgjidhet ne marreveshje ndermjet

Paleve, ne rast te kundert kompetente per zgjidhjen e konflikteve eshte Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

5.4. Kjo Kontrate hartohet ne gjuhen Shqipe ne 2 (dy) origjinale. Lexuar, pranuar e nenshkruar nga palet.

| SHITESIT | BLERESI |
| --- | --- |
| **Sabri Osma** | **Fabjan Diçi** |